



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË  
27.12.2022

Me datë 27.12.2022, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Brisela Kadija, Teuta Zaja, Bledianë Nika, Ardiana Ndeu, Diana Muriqi, Tereze Brigja, Jona Leqejza, Vjollca Petani, Daniela Jakoja, Nersada Mandija, Dhurata Tyli, Valbona Doniku, Donika Ndoja, Sabina Danaj, Erion Metushi, Suada Selimaj, Ornela Leka, Luan Heta, Elson Celiku, Julian Kraja, Anton Kaftalli, Hilmi Lakti, Avenir Celaj, Marjan Ndershtiqaj, Sead Cocja, Gerald Hasaj, Lush Marku, Sokol Zaimaj, Besmir Vukaj, Anton Deda, Gjergj Sokoli, Andi Hallunaj, Luigj Palushi, Lulash Nika, Nadir Spahija.

Mbledhja hapet nga Kryetarja e Këshillit, znj. Brisela Kadija.  
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim *“Për disa ndryshime në VKB nr.1 datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”*
2. Pr/ Vendim *“Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”*
3. Pr/ Vendim *“Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit”*
4. Pr/ Vendim *“Për miratimin e bursës së plotë/gjysëm burse, nxënësve që mësojnë në vitin e parë dhe në vitet e dyta e lart, për vitin shkollor 2022-2023 në Bashkinë Shkodër”*
5. Pr/ Vendim *“Për një ndryshim në VKB nr.19 datë 10.5.2022 “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë”*
6. Pr/ Vendim *“Për miratimin e planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën”*
7. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, vijohet me hedhjen në votim të rendit të ditës, ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

1.Mbledhja vijon me Pr/ Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr.1 datë 22.1.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër”

N/Kryetari i Bashkisë merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Në emër të komisionit për çështjet sociale, Znj.Mandija shprehet se ky pr/vendim përfshin një sërë lehtësirash fiskale për një target grup fëmijësh në nevojë dhe i fton këshillëtarët ta votojnë.

Edhe Z.Sokoli si kryetar i grupit të këshilltarëve të PSD shprehet pro këtij akti. Projekt akti i parë hidhet në votim, ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

2.Vijohet me pikën 2. të rendit të ditës: Pr/ Vendim “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër”

Fjalën e merr Kryetari i bashkisë, Z.Spahija i cili relaton në mënyrë të detajuar ku dhe thekson që ky pr/vendim vjen si rezultat i një pune të gjatë të punonjësve të administratës të Bashkisë Shkodër por edhe si rezultat i degjesave publike të mbajtura.

Një prezantim më të saktë bën edhe drejtoresha e zyrës së buxhetit, Znj.Teuta Haxhi, sipas relacionit të përgatitur.

Në emër të komisioneve referojnë Z.Kaftalli për Komisionin e Kulturës, Znj.Mandija për komisionin e çështjeve Sociale dhe Znj. Leqejza në emër të komisionit të Buxhetit, e cila kërkon të dijë cila metodologji, cila qasje do ndiqet përfundimisht pasi ajo vëren një mospërputhje materiale me atë çka është diskutuar në komision.

Edhe Z.Kraja shpreh shqetësimin e tij në lidhje me parashikimet për shëndetësinë, sipas tij ka mangësi dhe probleme për qendrat shëndetësore dhe ai mendon se ka përgjysmim të fondit për shëndetësinë. Ai kërkon të dijë ndërhyrjet që janë bërë në disa qendra dhe a janë kryer nga bashkia apo nga qeveria?

Znj.Haxhi përgjigjet që materiali i publikuar dhe ai i paraqitur është identik, thjesht ai është shumë voluminoz.

Z.Dedaj shton se nuk është paraqitur në fishet e buxhetit metodologjia megjënëse nuk është shpenzim. Ai sqaron se Reload do vazhdojë të funksionojë si metodologji vlerësimi për projektet. Kurse në lidhje me qendrat shëndetësore ai mendon se mund të ketë ndonjë keqkuptim sepse fondi nuk është përgjysmuar. Investimet e planifikuara për 2022 nuk janë

përmbyllur por janë në proces vlerësimi për tenderim, pra investime që do kryhen në 2023. Në tre qendra shëndetësore është investuar tashmë në bashkëfinancim me qeverinë.

Z.Kraja kërkon të dijë përse nuk janë kryer në 2022 këto investime, mos kanë lidhje me politikën dhe sa do i mbulojë fondi i parashikuar problemet e qendrave shëndetësore?

Përsëri përgjigjet Zv/Kryetari Z.Dedaj i cili sqaron që qendrat shëndetësore kanë tre burime financimi, nga Ministria e linjës nga Bashkia dhe me vetëfinancim. Kuptohet që çdo program kërkon fonde më të mëdha por mundësitë janë këto që janë. Megjithatë sipas vlerësimit tonë qendrat shëndetësore nuk janë në gjendjen që mendohen. Kurse për mosrealizime në 2022, duhet pranuar që për mungesë stafi bashkia nuk ka mundur të vlerësojë preventivat. Tashmë, ky vlerësim është kryer dhe ndërhyrja është vetëm çështje kohe.

Znj.Haxhi thotë se Bashkia nuk ka asnjë detyrim ligjor për investime në qendrat shëndetësore sepse nuk përfitojmë asnjë fond për këtë nga qeveria. E gjitha ka qënë nisëm e Bashkisë përfshirë edhe fondin e parashikuar në buxhet.

Z.Marku merr fjalën dhe shprehet se ky pr/vendim duhet të kishte prioritete më të mëdha ,të cilat ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve të Shkodrës. Sipas tij raporti me shpenzimet operative dhe investimet lë shumë për të dëshiruar sepse po të bëhet një analizë e viteve të mëparshme, shërbimet e ofruara nuk shkojnë në një linjë me ato të kryera nga Bashkia Shkodër. Edhe tek investimet, kemi plot probleme ose punë të lëna përgjysëm.

Znj. Brixha merr shkas nga prania e Kryetarit për të përsëritur shqetësimet e saja dhe për të vënë në vëmendje disa problematika të përditëshme të qytetit si p.sh; pastrimet e kanaleve, pastrimet e mbeturinave, varrezat e Stan Golemit ku nuk ka rrugë të mirëfilltë, dritat e qytetit etj.

Znj.Leqejza relatton dhe bën një analizë në mënyrë të detajuar, në emër të komisionit të buxhetit. Ajo thekson se vazhdon të mungojë bashkërendimi i Bashkisë Shkodër me kërkesat e Këshilltarëve. Vërehet akoma mungesa në shërbime bazike siç është transporti publik, arsimit, shëndetësia, ka mungesë strategjie për sportin, shërbimi social, kultura etj. Shpresojmë që me planet, që administrata e Bashkisë është angazhuar për të bërë në vitin 2023 të kemi hapa pozitiv. Duhet pranuar që ka një ndryshim në qasje përse i përket planit ekonomik, i cili është kompleks dhe duhet vlerësuar. Gjithashtu ajo bën edhe disa propozime dhe rekomandime nga këshilltarët në lidhje me lehtësirat fiskale për shtresat në nevojë, lehtësira për bizneset e hapura nga të rinjtë përfitues të granteve të vetëpunësimit, edhe projektet e tregjeve vazhdojnë të jenë me vlerë 0, por për sa kohë kemi thirrje për donatorë dhe financues ajo mendon se është kërkesë e përmbushur. Vlen për t'u përsëritur fakti që vërehet një standartizim në implementimin e sistemeve të pikëzimit. Tek programi i rrjetit rrugor rural mund të shihet se secili nga rajonet e Shkodrës, bazuar edhe në dëgjesat publike por edhe në bazë të vlerësimeve të kryera nga administrata ka tashmë një listë përparësish dhe kjo vlen për t'u përsëritur. Vlerësojmë edhe nismën për ndriçimin ekologjik në rrugët kryesore të qytetit. Ajo që lë për të dëshiruar është buxheti për adresarin e qytetit.

Rekomandimet e komisionit janë; të bëhet transparenca për përfituesit e subvencioneve të transportit publik, (nxënësit dhe studentët). Gjithashtu kërkohet edhe thjeshtëzimi i procedurave për të qënë përfitues. Kërkohet të kryhet studimi për planin e lëvizshmërisë dhe të zgjidhet njëherë e mirë situata e parkingjeve për rezidentët. Po ashtu kërkohet edhe studimi i një plani për sportin. Kërkohet edhe ndërtimi i një muzeu olimpik për vlerësimin e atyre, që kanë bërë historinë e sportit Shkodran. Duhet të ketë edhe buxhetim për kujdesin dhe mirëmbajtjen e monumenteve historike. Së fundmi, ajo kërkon që në buxhet të rikthehet edhe fishja e programit reload.

Z.Dedaj rimerr fjalën dhe thekson që të gjitha rekomandimet e komisionit janë mbajtur shënim nga administrata dhe do mundohemi të bëjmë korrigjimet e duhura, që çdo gjë të jetë transparente për publikun.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

**3.**Kalohet në pikën 3. të rendit të ditës; Pr/ Vendim *“Për miratimin e kriterëve të përdorimit të intensitetit të ndërtimit me kushte si instrument i zhvillimit të territorit”*

Z. Koçiqi merr fjalën dhe relaton sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës.

Edhe Z.Heta në emër të komisionit të planifikimit të territorit relaton duke evidentuar dhe ndryshimet përkatëse të diskutuara dhe në dëgjuesën publike të zhvilluar.

Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

### Miratohet

**4.**Kalohet në pikën 4. Pr/ Vendim *“Për miratimin e bursës së plotë/gjysëm burse, nxënësve që mësojnë në vitin e parë dhe në vitet e dyta e lart, për vitin shkollor 2022-2023 në Bashkinë Shkodër”*

Relaton për të sipas materialit të përgatitur nga punonjësit e administratës Z.Ivziku, drejtor i Zyrës së arsimit në Bashkinë Shkodër.

Znj.Brixha rimerr fjalën dhe shprehet se ka vërejtjet e saja në lidhje me përfituesit e bursave, sipas saj më shumë përfitues ka në shkollat profesionale, duke ditur që këto shkolla ndiqen kryesisht nga nxënës të dobët , prandaj ajo e sheh më të arsyeshme që bursat të shërbejnë si nxitje për nxënës që kanë rezultate të mira.

Në emër të komisionit Z.Zaimaj shprehet pro këtij pr/vendimi. Kalohet në mendimin e kryetarëve të grupeve; Znj.Mandija dhe Z.Sokoli shprehen gjithashtu pro. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

### Miratohet

5.Kalohet në pikën 5. Pr/ Vendim "Për një ndryshim në VKB nr.19 datë 10.5.2022 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të Bashkisë Shkodër dhe institucioneve të varësisë"

Relaton përsëri Z.Dedaj, i cili thekson që ky pr/vendim është thjesht një implementim i ndryshimit të pagës minimale në bazë të VKM-së.

Znj.Leqejza në emër të komisionit shpreh dakortësi , po ashtu edhe kryetarët e grupeve Znj.Mandija dhe Z.Sokoli janë pro pr/vendimit. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

6.Kalohet në pikën 6. të rendit të ditës; Pr/ Vendim "Për miratimin e planit vendor të veprimit për migracionin dhe diasporën.

Përsëri relaton zv/Kryetar Z.Dedaj sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Mandija shprehet pro në emër të komisionit. Po ashtu edhe kryetarët e grupeve janë dakort me pr/vendimin. Projekt akti hidhet në votim, ku rezultojnë 26 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Fjalën e merr Znj.Danaj, e cila rikthen në kujtesë shqetësimin e saj në lidhje me kinema Millenium. Por përgjigjja e saj lihet për mbledhjen e radhës.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Znj.Kadija e deklaron mbledhjen të mbyllur.

*Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmblodhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 27.12.2022. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).*

*Procesverbali përmban 5 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:*

**Sekretar**

**Denis LESHJA**

